



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
JURIA

Nr. 1174 Prot.

Tiranë, më 08.07.2026

Vendim nr. 63 datë 08.07.2026

Për dhënien e mirënjohjes *Nderi i Akademisë*
tre personaliteteve të shquara

Referuar nenit 10 të *Rregullores për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre*; në mbështetje të Vendimit të Kryesisë nr. 19 datë 24.05.2022 *Për mirënjohjen “Nderi i Akademisë” dhe për kriteret e procedurat e dhënies së saj*; me propozim të komisionit të përhershëm të biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë, në shkresat me nr. prot. 1029, datë 17.07.2026 dhe nr. prot. 1212, datë 28.07.2025 (bashkëngjitur); në shkresat e SSHNT me nr. Prot. 1127/1, datë 03.07.2026 dhe me nr. prot. 1161, datë 07.07.2026 (bashkëngjitur); pasi konstatoi plotësimin e kriterëve dhe zbatimin e procedurave sipas parashikimeve si më sipër; Juria, në mbledhjen e saj të datës 08.07.2026,

Vendosi:

1. T’i jepet mirënjohja *Nderi i Akademisë* personaliteteve të shquara të biologjisë, përkatësisht:

- Prof. Maurizio Lambardi, biolog

Me motivacionin:

Për kontributin e tij të shquar në zhvillimin e bioteknologjisë bimore, kulturave in vitro, kriokonservimit dhe ruajtjen e burimeve gjenetike bimore, për mbështetjen e vazhdueshme të kërkimit shkencor në Shqipëri nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe institucionet kërkimore shqiptare, në realizimin e projekteve të përbashkëta ndërkombëtare, transferimin e metodave dhe teknologjive bashkëkohore, ngritjen e kapaciteteve kërkimore, formimin e studiuesve

të rinj, publikimet e përbashkëta shkencore dhe forcimin e bashkëpunimit akademik e shkencor ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, duke dhënë një kontribut të çmuar në ndërkombëtarizimin dhe zhvillimin e shkencës shqiptare.

- Prof. Munis Dundar, biolog

Me motivacionin:

Për kontributin e dhënë në krijimin dhe konsolidimin e partneritetit ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Komitetit Ekzekutiv të Shoqatës Evropiane të Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë (European Biotechnology Thematic Network Association – EBTNA), organizimin e kongreseve, konferencave dhe shkollave ndërkombëtare në Shqipëri, nxitjen e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe rrjeteve akademike, krijimin e mundësive për përfshirjen e studiuesve shqiptarë në iniciativat evropiane të bioteknologjisë, si dhe në forcimin e marrëdhënieve shkencore ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe institucioneve kërkimore ndërkombëtare.

- Prof. Robert Marks, biolog

Me motivacionin:

Për kontributin në zhvillimin e bioteknologjisë, biosensorëve dhe inovacionit, mbështetjen e vazhdueshme në krijimin e partneriteteve strategjike, zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, organizimin e aktiviteteve shkencore të përbashkëta, si dhe rolin në ndërkombëtarizimin e veprimtarisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke krijuar ura të qëndrueshme bashkëpunimi në dobi të zhvillimit të kërkimit shkencor, inovacionit dhe transferimit të teknologjisë.

3. Mirënjohja Nderi i Akademisë të jepet përmes një ceremonie publike të organizuar sipas përshkrimit në Rregulloren për ceremonialin dhe solemnitetet në aktivitete të cilat do të zhvillohen nga Akademia e Shkencave, në një kohë sa më të afërt.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: sekretari shkencor, kryetari i SSHNT dhe kancelari.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI
KRYETAR

